



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 204

30 dhjetor

2013

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr. 185/2013
datë 2.12.2013

Për buxhetin e vitit 2014.....

Faqe

9065

LIGJ
Nr. 185/2013

PËR BUXHETIN E VITIT 2014

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, 84, pika 4, dhe 158, të Kushtetutës, dhe të nenit 30 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

KREU I
BUXHETI

Neni 1

Buxheti për vitin 2014 është:

Të ardhurat	364 704 milionë lekë;
Shpenzimet	456 404 milionë lekë;
Deficiti	91 700 milionë lekë.

Ai përbëhet nga Buxheti i Shtetit, buxheti vendor dhe fondet speciale: sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i pronarëve.

Neni 2

Buxheti i Shtetit për vitin 2014 është:

Të ardhurat	290 183 milionë lekë;
Shpenzimet	381 883 milionë lekë;
Deficiti	91 700 milionë lekë.

Neni 3

Buxheti vendor për vitin 2014 është:

Të ardhurat	33 129 milionë lekë;
Nga të cilat:	
Granti i pakushtëzuar nga buxheti qendror	19 156 milionë lekë;
Të ardhura të tjera	13 973 milionë lekë;
Shpenzimet	33 129 milionë lekë.

Neni 4

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2014 është:

1. Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror

Të ardhurat, gjithsej	95 304 milionë lekë;
Nga të cilat:	
- kontributet	53 200 milionë lekë;
- transferimet nga Buxheti i Shtetit	42 104 milionë lekë;
Shpenzimet	95 304 milionë lekë.

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, përcaktohet nga Këshilli i Ministrave dhe ndryshon sa herë që rriten pagat dhe pensionet. Këshilli i



Ministrave ka të drejtë të përcaktojë një kontribut të veçantë minimal për personat e vetëpunësuar në bujqësi dhe për kategoritë specifike të personave të vetëpunësuar. Diferenca ndërmjet kontributeve të veçanta me kontributin minimal mbulohet nga transfertat e Buxhetit të Shtetit, por jo më shumë se kufijtë e transfertave të përcaktuara në këtë ligj. Për vitin 2014, teprica e të ardhurave, sipas programeve dhe degëve të sigurimit shoqëror, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

2. Skema e sigurimit suplementar

Të ardhurat, gjithsej 5 496 milionë lekë;

Nga të cilat:

- kontributet 730 milionë lekë;

- transferimet nga Buxheti i Shtetit 4 766 milionë lekë;

Shpenzimet 5 496 milionë lekë.

Shpenzimet administrative, si pjesë e shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më shumë se 1 930 milionë lekë dhe ndahen sipas skemave në proporcion me shpenzimet e drejtpërdrejta.

Neni 5

Buxheti i sigurimeve shëndetësore për vitin 2014 është:

Të ardhurat, gjithsej 32 910 milionë lekë;

Nga të cilat:

- kontributet dhe të tjera 8 619 milionë lekë;

- transferimet nga Buxheti i Shtetit 24 291 milionë lekë;

Shpenzimet 32 910 milionë lekë.

Fondi për shërbimin spitalor detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Buxheti i fondit për kompensimin në vlerë të pronarëve për vitin 2014 është:

Të ardhurat, gjithsej 1 600 milionë lekë;

Nga të cilat:

- të ardhura të tjera 1 300 milionë lekë;

- transferimet nga Buxheti i Shtetit 300 milionë lekë;

Shpenzimet 1 600 milionë lekë.

Neni 7

Përdorimi dhe investimi i fondit rezervë të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore bëhen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

KREU II

BURIMET PËR MBËSHTETJEN E SHPENZIMEVE TË BUXHETIT TË SHTETIT

Neni 8

Të ardhurat e Buxhetit të Shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

Grantet 8 500 milionë lekë;

Të ardhurat tatimore 260 517 milionë lekë;

Të ardhurat jotatimore 21 166 milionë lekë.

Neni 9

Kufiri i financimit të deficitit të Buxhetit të Shtetit nga burime të brendshme dhe të huaja është 91 700 milionë lekë, nga i cili 400 milionë lekë financohen nga të ardhurat e privatizimit. Në rast mosrealizimi të të ardhurave të buxhetit dhe të të ardhurave nga privatizimi, huamarrja totale për financimin e deficitit prej 91 300 milionë lekësh nuk ndryshon. Këshilli i Ministrave merr masa për kompensimin e diferencave nga burime suplementare ose nga shkurtimi i shpenzimeve.

Të ardhurat nga privatizimi mbi shumën e parashikuar në këtë buxhet përdoren jo më pak se 50 për qind për uljen e borxhit publik dhe pjesa tjetër përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për rritjen e kufirit të shpenzimeve kapitale, e cila, automatikisht, rrit kufirin e deficitit të Buxhetit të Shtetit, të përcaktuar në nenet 1 dhe 2 të këtij ligji.

KREU III SHPENZIMET E BUXHETIT TË SHTETIT

Neni 10

Shpenzimet e Buxhetit të Shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

Shpenzimet korrente	273 123	milionë lekë;
Shpenzimet kapitale	67 260	milionë lekë;
Fondi rezervë	1 500	milionë lekë;
Kontingjenca	3 000	milionë lekë;
Fondi për rritjen e pagave dhe pensioneve	2 000	milionë lekë;
Detyrimet e prapambetura	35 000	milionë lekë.

Kufiri i shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion, në nivel programi, është sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Detyrimet e prapambetura shpërndahen sipas rregullave, procedurave dhe kriterëve të vendosura me vendim të Këshillit të Ministrave dhe regjistrohen, sipas ministrive përkatëse, mbi kufirin e miratuar në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Fondi i kompensimeve prej 1 100 milionë lekësh përdoret për kompensimin e shtresave në nevojë, sipas rregullave, procedurave dhe kriterëve të vendosura me vendim të Këshillit të Ministrave dhe u shpërndahen ministrive përkatëse mbi kufirin e miratuar në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Këshilli i Ministrave vendos norma dhe standarde financiare për shpenzimet publike, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Neni 11

Numri i përgjithshëm i punonjësve në organikë është 86 500 punonjës. Numri maksimal i punonjësve për çdo ministri dhe institucion qendror, i dhënë në tabelën 2, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij, detajohet nga ministrinë dhe institucionet qendrore, në përputhje me strukturat e miratuara për çdo institucion varësie. Këshilli i Ministrave mund të rialokojë numrin e punonjësve ndërmjet institucioneve të përmendura në tabelën 2, në rastin e ristrukturimit të institucioneve ekzistuese apo krijimit të institucioneve të reja. Numri rezervë, i parashikuar në tabelën 2, përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për krijimin e institucioneve të reja. Këshilli i Ministrave përcakton numrin maksimal të punonjësve me kontratë të përkohshme për çdo ministri dhe institucion qendror. Fondi i veçantë i institucioneve buxhetore prej 1 200 milionë lekësh, shpërndahet dhe përdoret me miratimin e Ministrisë të Financave dhe sipas procedurave që përcaktohen me udhëzim të tij.



Për vitin 2014 nuk miratohet asnjë ndryshim në strukturat organike të njësisve të qeverisjes qendrore me efekte financiare shtesë në koston e personelit, të përlogaritur sipas strukturës së miratuar, me përjashtim të institucioneve të reja të krijuara.

Ky përcaktim përfshin edhe ato struktura, në të cilat paga për funksion jepet ose është sipas gradës përkatëse, ku çdo rritje në gradë do të bëhet efektive vetëm nëse nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë në koston e përlogaritur sipas gradave të miratuara.

Neni 12

Paga e Presidentit të Republikës është 257 000 lekë në muaj.

Neni 13

Fondi rezervë i buxhetit prej 1 500 milionë lekësh përdoret nga Këshilli i Ministrave për raste të paparashikuara të institucioneve buxhetore. Fondi i kontingjencës prej 3 000 milionë lekësh përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave. Fondi për rritjen e pagave e të pensioneve prej 2 000 milionë lekësh shpërndahet nga Ministri i Financave, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave.

Neni 14

Buxheti i pushtetit gjyqësor administrohet nga Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, në mbështetje të ligjit nr. 8363, datë 1.7.1998, "Për krijimin e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor". Bordi i kësaj zyre bën shpërndarjen e fondeve buxhetore nga programi i buxhetit gjyqësor, sipas tri niveleve të këtij pushteti.

Neni 15

Transfertat e pakushtëzuara, që buxheti qendror ia transferon pushtetit vendor, përfshijnë fondet për përballimin e veprimtarive dhe të funksioneve që përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Transfertat e pakushtëzuara shpërndahen ndërmjet njësisve të pushtetit vendor, sipas formulës së paraqitur në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Shuma e transfertës së pakushtëzuar për çdo njësi të pushtetit vendor paraqitet në tabelën 3, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Fondi i kompensimit nga totali i transfertës së pakushtëzuar përdoret nga Ministria e Financave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij ligji. Fondet për zhvillimin e rajoneve shpërndahen sipas aneksit 3, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Fondet për konviktet e arsimit parauniversitar shpërndahen sipas aneksit 4, që i bashkëlidhet këtij ligji. Fondet për administrimin e qendrave të shërbimit social shpërndahen sipas aneksit 5, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Bashkitë, që kanë deri në 20 000 banorë, përdorin deri në 25 për qind të transfertës së pakushtëzuar për koston e personelit administrativ.

Bashkitë, që kanë 20 001 - 50 000 banorë, përdorin deri në 20 për qind të transfertës së pakushtëzuar për koston e personelit administrativ.

Bashkitë, që kanë mbi 50 001 banorë, përdorin deri në 15 për qind të transfertës së pakushtëzuar për koston e personelit administrativ.

Komunat, që kanë deri në 3 000 banorë, përdorin deri në 45 për qind të transfertës së pakushtëzuar për koston e personelit administrativ.

Komunat, që kanë 3 001 - 10 000 banorë, përdorin deri në 40 për qind të transfertës së pakushtëzuar për koston e personelit administrativ.

Komunat, që kanë 10 001 - 15 000 banorë, përdorin deri në 35 për qind të transfertës së pakushtëzuar për koston e personelit administrativ.

Komunat, që kanë mbi 15 001 banorë, përdorin deri në 30 për qind të transfertës së pakushtëzuar për koston e personelit administrativ.

Këshillat e qarqeve përdorin deri në 50 për qind të transfertës së pakushtëzuar për koston e personelit administrativ.

Pjesa e të ardhurave nga renta minerare, që u takon njësisve të qeverisjes vendore, shpërndahet nga Ministria e Financave, sipas kërkesave të njësisve të qeverisjes vendore, në përputhje me procedurat ligjore dhe formulën e dhënë në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Kur shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve dhe njësitë e qeverisjes vendore për sistemin e pompimit rezultojnë debitore për furnizimin me energji elektrike ndaj kompanisë së shpërndarjes, deri në fund të tremujorit të tretë, transfertat e pakushtëzuar të njësisve të qeverisjes vendore të tremujorit të katërt bllokohet dhe përdoret për shlyerjen e këtyre detyrimeve.

Fondet që, sipas këtij neni, u vihen në dispozicion njësisve të qeverisjes vendore, fondet e tjera që, me akte të tjera ligjore dhe nënligjore, u kalojnë njësisve të qeverisjes vendore, si dhe me vendimet e këshillave komunalë, bashkiakë dhe të këshillave të qarqeve, që kanë lidhje me përdorimin e fondeve buxhetore, bëhen publike.

Neni 16

Fondet e Buxhetit të Shtetit për arsimin e lartë shpërndahen në formën e grantit. Formula për ndarjen e grantit jepet në aneksin 6, që i bashkëlidhet këtij ligji. Kriteret për përdorimin e granteve konkurruese në arsimin e lartë janë të njëjta me ato të përcaktuara në aneksin 3, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 17

Kufiri i shpenzimeve, sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij ligji, mund të rishpërndahet gjatë vitit ndërmjet programeve brenda të njëjtit institucion buxhetor apo ndërmjet programeve të institucioneve të ndryshme nga Këshilli i Ministrave, deri në masën 10 për qind të shumës së përgjithshme të shpenzimeve korrente apo shpenzimeve të përgjithshme kapitale, duke ruajtur totalin e shpenzimeve korrente dhe kapitale.

Neni 18

Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit dhe atij të garantuar të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, për vitin 2014, është 120 403 milionë lekë, i dhënë me hollësi, si më poshtë:

1. Për huamarrjen vjetore neto për mbështetjen buxhetore deri në 45 800 milionë lekë.
2. Për huamarrjen neto për financimin e projekteve të huaja deri në 27 313 milionë lekë.
3. Për rritjen vjetore të garancive të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, deri në 8 290 milionë lekë.

4. Kufiri për rritjen vjetore të stokut të borxhit, si rezultat i mbështetjes buxhetore për pagesën e detyrimeve të prapambetura deri në 35 000 milionë lekë.

Stoku i borxhit shtetëror, përfshirë kursin e këmbimit, vlerësohet të arrijë 961 863 milionë lekë.

Stoku i borxhit të garantuar, përfshirë kursin e këmbimit, vlerësohet të arrijë 66 180 milionë lekë.

Neni 19

Ngarkohet Ministria e Financave të nxjerrë udhëzime për zbatimin e këtij ligji.



Neni 20

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2014.

Miraturar në datën 28.12.2013

Shpallur me dekretin nr.8452, datë 30.12.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

ANEKS 1

FORMULA E TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR - KRITERET DHE KOEFICIENTËT

Kriteri	Koeficienti	Vlera (në mijë lekë)	Arsyeja themelore
Transferta e pakushtëzuar gjithsej (13,306,000 mijë lekë) [TP]			
Transferta e pakushtëzuar për një bashki/komunë ose qark është e barabartë me shumën përkatëse që rezulton nga aplikimi i formulës për shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar dhe transferua konviktet dhe shërbimet sociale.			
Alokimi i transfertës së pakushtëzuar – (shuma 12,582,915 mijë lekë) [TP]			
Pjesa e qarqeve [Q]	9%	1,132,462	Ky raport u jep qarqeve fonde për shpenzimet e tyre administrative, për mirëmbajtje dhe investime të rrugëve rurale dhe për shpenzime të tjera operative.
Pjesa për bashkitë/komunat [B/K]	91%	11,450,453	Për të siguruar financimin e funksioneve kryesore të ushtruara nga niveli i parë i qeverisjes vendore (bashki/komune).
1. Shpërndarja e pjesës së bashkisë/komunës [B/K]			
Grand i përgjithshëm [GP] = [GP] * 1.00	100%	11,450,453	Pjesa e plotë për B/K alokohet në hapin e parë në grandin e përgjithshëm.
2. Shpërndarja e grantit të përgjithshëm për bashkitë/komunat			
Popullsia [P-B/K] = [GP-B/K] * 0.70	70.0%	8,015,317	Ky është kriteri kryesor pasi popullsia është një tregues i lidhur ngushtë me shpenzimet dhe nevojat për shërbime. Alokimi i [P-B/K] ndahet proporcionalisht me popullsinë relative të çdo bashki/komunë kundrejt popullsisë totale. Popullsia për vitin 2014 është marrë nga të dhënat e Gjendjes Civile të muajit shtator 2013.
Sipërfaqja e komunave [S-K] = [GP-B/K] * 0.15	15%	1,717,568	Ky element është i aplikueshëm vetëm për komunat. Komunë me sipërfaqe më të madhe nënkupton (për të gjitha kushtet e tjera të barabarta) ka rrugë më të gjata dhe shpenzime të tjera infrastrukturore që kushtojnë. Alokimi i [S-K] ndahet proporcionalisht me

Kriteri	Koeficienti	Vlera (në mijë lekë)	Arsyeja themelore
			sipërfaqen relative të çdo komune kundrejt sipërfaqes totale. Për komuna malore sipërfaqja është llogaritur si totali i sipërfaqes bazë shtuar me katër herë.
Shërbimet urbane [SHU-B] = $[GP-B/K] * 0.15$	15%	1,717,568	Ky koeficient për simetri me komunat është 15% e totalit të fondit dhe ndahet proporcionalisht me popullsinë relative të çdo bashkie kundrejt popullsisë totale të bashkive. Për bashkitë e vlerësuara si bashki në nevojë, koeficienti i shërbimeve urbane është llogaritur duke shtuar me 2 herë numrin faktik të popullsisë. Për bashki malore, koeficienti i shërbimeve urbane është llogaritur duke shtuar me 2 herë numrin faktik të popullsisë. Për bashkitë malore e njëkohësisht në nevojë, koeficienti i shërbimeve urbane është llogaritur duke shtuar 4 herë numrin faktik të popullsisë për këto bashki.
3. Rregullimi i ekualizimit fiskal për bashkitë dhe komunat			
Ekualizimi fiskal $(B/K_{PCR}-N_{PCR}) * (+/- 25\%)*Popullsia$ [PCR] -TAPF = Të ardhura për frymë N = nacionale	25%	1,087,397	Ekualizimi fiskal bazohet në të ardhurat faktike të vitit 2012, të taksës vendore të biznesit të vogël dhe taksës së automjeteve të përdorura. B/K që kanë të ardhura për frymë më të larta se sa të ardhurat nacionale për frymë kontribuojnë 25% të diferencës ndërmjet të dyjave shumëzuar me popullsinë e tyre. B/K që kanë të ardhura për frymë me të ulëta se të ardhurat nacionale për frymë marrin 25% të së njëjtës diferencë të llogaritur në të njëjtën mënyrë.
Rregullimi transitor (rezultati +1 % kundrejt vitit 2013) $(B/K_{R2013})*(101)$ R = të ardhura për një vit të dhënë	Kufiri +1. % koeficienti 101 %	292,566	B/K të cilat, pas rezultateve të ekualizimit fiskal kanë një grand që është më i ulët se 101 % i vitit 2013 kompensohen për diferencën.
Rregullimi transitor (rezultatet kundrejt vitit 2013)	Kufiri > 8 % Koeficienti 8 %	(752,326)	Pas rezultateve të ekualizimit fiskal, ato B/K të cilat përfitojnë një rritje mbi 8 % krahasuar me vitin 2013, kontribuojnë për rritjen e garancisë minimale për fryme dhe fondin e kompensimit në masën e tejkalimit mbi 8 % krahasuar me rezultatin e transfertës të vitit 2013.
Kompensimi i garancisë minimale për frymë	B – 3,220 minimumi për frymë K – 2,000 minimum për frymë	299.864	Për të siguruar një të ardhur të garantuar minimale për frymë, ky kompensim krahason të ardhurat përfundimtare për frymë (grandit të përshtatur për tranzicion, plus të ardhurat fiskale të listuar më përpara) me garancinë minimale prej (2,000 lekë/për frymë për komunat dhe 3,220 lekë/për frymë për



Kriteri	Koeficienti	Vlera (në mijë lekë)	Arsyeja themelore
			bashkitë). Bashkitë ose komunat marrin diferencën ndërmjet të dyjave, shumëzuar me popullsinë e tyre.
Fondi neto i kompensimit për bashkitë dhe komunat [FNK-B/K]		159,895	Ky fond është produkt i elementeve të mëposhtme: - Kompensimi tranzitor për kufi të poshtëm (dysHEME) + Kompensimi tranzitor për kufi të sipërm (tavan) - Kompensimi i garancisë minimale për frymë Përdorimi i fondit kompensues për B/K bëhet sipas kritereve të përshkruara në aneksin nr.2.
4. Renta minerare			
Renta minerare	+50% te transfertës së pakushtëzuar për naftën dhe gazin dhe +80% të transfertës së pakushtëzuar për mineralet		Renta minerare u alokohet njësisë të qeverisjes vendore sipas kërkesës së tyre. Njësitë e qeverisjes vendore përfitojnë +50% për naftën dhe gazin dhe +80% për mineralet si rentë minerare mbi transfertën e pakushtëzuar pasi transfertat dhe renta të jenë barazuar.
5. Fonde për konviktet e arsimit parauniversitar			
Grand i përgjithshëm	100%	476,541	Alokimi i fondeve për paga dhe sigurime shoqërore bëhet proporcionalisht me numrin e punonjësve (punonjës dhe edukator) sipas konvikteve në bashkitë: Berat, Çorovodë, Peshkopi, Burrel, Durrës, Gjirokastrë, Tepelenë, Përmet, Fier, Lushnjë, Elbasan, Cërrik, Gramsh, Korçë, Ersekë, Leskovik, Lezhë, Rrëshen, Rubik, Kukës, Krumë, Shkodër, Pukë, Tiranë, Vlorë, Sarandë dhe komunave, Qendër Fier, Golem Kavajë, Kelmend Malësi e Madhe dhe Bushat Shkodër.
6. Fonde për qendrat e shërbimeve sociale			
Grand i përgjithshëm	100%	62,544	Alokimi i fondeve për qendrat e shërbimeve sociale "Lira", Berat, "Balash" Elbasan, "Shpresa" Shkodër dhe qendrat ditore për fëmijë me aftësi të kufizuara në qytetet Kuçovë dhe Kukës, është bërë respektivisht për bashkitë Berat, Elbasan, Shkodër, Kuçovë dhe Kukës.
7. Fonde për bashkitë në UNESCO			
Grand i përgjithshëm	100%	10,000	Bashkitë Berat dhe Gjirokastrë që janë të pranuar në UNESCO (Konventa për Mbrojtjen e Kulturës Botërore dhe Trashëgimisë Natyrore) u akordohen nga 5,000 lekë secilës.
8. Rregullime të ndryshme			
Grand i përgjithshëm	100%	174,000	Përmirësime të disa treguesve të formulës që

Kriteri	Koeficienti	Vlera (në mijë lekë)	Arsyeja themelore
			ndër vite ishte dobësuar efekti i tyre. Përmirësimet janë bërë nga Kuvendi.
9. Shuma finale e grandit për bashkitë dhe komunat			
Shuma në total e shpërndarjes së grandit për bashkitë dhe komunat		12,013,642	Në këtë shumë përfshihen fondet a ndara nga formula për të financuar funksionet kryesore të ushtruara nga niveli i parë i qeverisjes vendore, fondet që jepen për konviktet e arsimit parauniversitar, fondet për qendrat e shërbimeve sociale dhe fondet për bashkitë në UNESCO.
10. Shpërndarja e pjesës së grandit për qarqet			
Grandi i përgjithshëm për qarqet	99%	1,121,138	Për financimin e funksioneve bazë të qarqeve.
Fondi i kompensimit për qarqet	1%	11,325	Për financimin e rasteve të veçanta të shpenzimeve të qarqeve
11. Shpërndarja e grandit të përgjithshëm për qarqet			
Shuma fikse [SF-Q] = [Q] * 0.10	10%	112,114	Shuma fikse alokon një shumë të barabartë për çdo qark. Shuma në total [SF-Q] ndahet barabar mes qarqeve (pjesëtohet me numrin e qarqeve 12).
Popullsia [P-Q] = [Q] * 0.28	28%	313,919	Alokimi i [P-Q] bëhet proporcionalisht me popullsinë relative të çdo qarku kundrejt totalit të popullsisë. Për vitin 2014 popullsia për qarqet janë marrë nga të dhënat e Gjendjes Civile të muajit shtator 2013.
Treguesi gjeografik [KG-Q] = [Q] * 0.30	30%	336,341	Ky është një tregues i rëndësishëm që merr parasysh avantazhet dhe disavantazhet natyrore të vendndodhjes së qarkut. Për të karakterizuar tri zonat tipike të vendit: fushore-kodrinore-malore u përdor një shkallë përkatëse 1-3-5. Sa më e lartë shkalla, aq më të mëdha fondet që do të alokohen për këtë koeficient. Alokimi i [KG-Q] bëhet proporcionalisht me raportin e shkallës së qarkut kundrejt shumës së shkallëve për të gjithë qarqet (32).
Koeficienti i rrugës [R-k] = [Q] * 0.32	32%	358,764	Alokimi [KR] ndahet proporcionalisht me gjatësinë relative të rrugëve për secilin qark, kundrejt gjatësisë totale.
12. Fonde të disponueshme për kompensim			
a. Kompensimi për B/K b. Kompensimi për Q TOTALI		159,895 11,325 171,220	Përdorimi i fondit të kompensimit do të bazohet në kriteret e caktuara në aneksin nr.2 të ligjit të buxhetit të vitit 2014, ndërsa procedurat për alokimin e këtij fondi përcaktohen në udhëzimin nr. 2, datë 6.02.2012, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", si dhe në udhëzimin e zbatimit të buxhetit të vitit 2014.



ANEKS 2 KRITERET E SHPËRNDARJES SË FONDIT TË KOMPENSIMIT

Nivelet e pushtetit vendor	Kriteret
A. Fonde vetëm për bashkitë dhe komunat	<ul style="list-style-type: none"> • Kompensimi për ripërshtatjen e kapacitetit fiskal, të biznesit të vogël të pakompensuar, apo tregues të tjerë jo të saktë në përlllogaritjet e formulës. • Për nevoja të ndryshme financiare të bashkive dhe komunave. • Për konviktet e transferuar në nivel vendor.
B. Fonde vetëm për qarqet	<ul style="list-style-type: none"> • Për shpenzime të ndryshme që mund të nevojiten gjatë vitit.

Procedurat për alokimin e këtij fondi përcaktohen në udhëzimin nr. 2, datë 6.02.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, si dhe në udhëzimin e zbatimit të buxhetit të vitit 2014.

ANEKS 3

Fondi për Zhvillimin e Rajoneve

1. Në kuptim të këtij ligji, fjala rajon njehsohet me njësinë territoriale të qarkut në Republikën e Shqipërisë.

II. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përbëhet nga:

- Granti konkurrues për infrastrukturën vendore;
- Granti konkurrues për arsimin bazë dhe parauniversitar;
- Granti konkurrues për shëndetësinë;
- Granti konkurrues për objektet kulturore dhe të trashëgimisë kulturore;
- Granti konkurrues për ujësjellës-kanalizime;
- Granti konkurrues për ujitjen dhe kullimin;
- Granti konkurrues për pyllëzimin.

III. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përdoret për financimin e projekteve, të cilat ndodhen brenda territorit të një ose më shumë njësive të qeverisjes vendore, dhe zbatohen prej tyre.

IV. Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve përbëhet nga:

- | | |
|--|---------|
| 1. Kryeministri | Kryetar |
| 2. Zëvendëskryeministri | Anëtar |
| 3. Ministri i Financave | Anëtar |
| 4. Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit | Anëtar |
| 5. Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës | Anëtar |
| 6. Ministri i Arsimit dhe Sportit | Anëtar |
| 7. Ministri i Shëndetësisë | Anëtar |
| 8. Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave | Anëtar |
| 9. Ministri i Kulturës | Anëtar |
| 10. Ministri i Mjedisit | Anëtar |
| 11. Ministri i Brendshëm | Anëtar |
| 12. Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore | Anëtar |
| 13. Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë | Anëtar |
| 14. Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë | Anëtar |
| 15. Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë | Anëtar |
| 16. Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore | Anëtar |

V. Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve miraton:

a) kriteret për ndarjen e fondeve mes rajoneve, sipas propozimit të sekretariatit të përgjithshëm;

b) shpërndarjen e fondeve sipas qarqeve përkatëse, për projekte të fushave të pikës II, bazuar në propozimet e sekretariatit të përgjithshëm;

c) projektet, bazuar në vlerësimin e kryer sipas procedurave përkatëse të vlerësimit, mbi bazën e politikave dhe programeve të zhvillimit të rajoneve të Shqipërisë.

VI. Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve diskuton dhe jep orientim për shpërndarjen sipas fushave të pikës II të fondit total të buxhetit të përcaktuara për projekte të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, përpara miratimit në Këshillin e Ministrave të projektbuxhetit për vitin pasardhës.

VII. Masa e kontributit/bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes vendore përcaktohet nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve.

VIII. Aplikimi për fonde bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore, shoqëritë aksionare të ujësjellësve, universitetet dhe bordet e kullimit. Aplikimi për projekte kryhet online në faqen e internetit të Këshillit të Ministrave, Sekretariati i Përgjithshëm i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve. Institucionet aplikuese dërgojnë pranë Departamentit të Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj, listën e plotë të projekteve të aplikuar të kryera online.

IX. Pranë Zyrës së Kryeministrit, si pjesë e Departamentit të Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj, ngrihet Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve. Sekretariati i përgjithshëm:

a) propozon dhe përgatit për diskutim në Komitetin për Zhvillimit Rajonal shpërndarjen sipas fushave të pikës II të fondit total të buxhetit të përcaktuar për projekte të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve;

b) propozon për miratim në Komitetin për Zhvillimit Rajonal kriteret për ndarjen e fondeve mes rajoneve;

c) analizon projektet e investimeve, në përputhje me prioritetet strategjike kombëtare dhe të programit politik të Qeverisë, sipas informacioneve të marra nga sekretariatet teknike në ministritë e linjës;

d) përgatit dosjen sintetike në nivel qarku të të gjitha projekteve për shqyrtim dhe miratim nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve;

e) përpunon informacionin e marrë nga sekretariatet teknike të ministrive të linjës lidhur me situatën financiare, ecurinë e punimeve, si edhe çështje të zbatimit të zbatimit të projekteve, për t'i paraqitur për shqyrtim, sipas rastit, Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve;

f) përgatit raporte për monitorimin e ecurisë së punimeve dhe financimeve për shqyrtim nga Kryetari i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve dhe/ose Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve.

X. Në ministritë përkatëse të linjës, Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, si dhe në Fondin Shqiptar të Zhvillimit (për infrastrukturën vendore), ngrihen sekretariatet teknike. Sekretariatet teknike:

a) janë pika kontakti për sekretariatit e përgjithshëm, në lidhje me çdo informacion për Fondin për Zhvillimin e Rajoneve që përcillet nga/apo në ministritë përkatëse;

b) kryejnë vlerësimin e projekteve të propozuara nga aplikuesit, sipas kriterëve të miratuara nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve;

c) dërgojnë pranë sekretariatit të përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, listën e projektaplikimeve të hedhura në sistemin online (nga aplikuesit sipas pikës VIII), të shoqëruara me vlerësimet përkatëse sipas kriterëve;

d) monitorojnë dhe ndjekin ecurinë e punimeve të projekteve dhe disbursimit të fondeve, duke paraqitur, sipas kërkesës, pranë sekretariatit të përgjithshëm të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, raporte lidhur me ecurinë e zbatimit dhe disbursimit të projekteve;

e) raportojnë pranë Ministrisë së Financave, në përputhje me procedurat e përcaktuara në



aktet ligjore të buxhetit.

XI. Sekretariati teknik në Ministrinë e Financave ndjek procedurën e çeljes dhe disbursimit të fondeve për projektet, në përputhje me vendimet e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, si edhe raporton pranë sekretariatit të përgjithshëm për ecurinë e çeljes dhe disbursimeve lidhur me thesarin.

XII. Në procesin e marrjes së vendimit, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve trajton me prioritet projekte strategjike me ndikim në zhvillimin ekonomik të rajoneve, për të cilat mund të jetë siguruar bashkëfinancim nga pushteti vendor dhe/apo donatorë të tjerë, apo që mund të përfundojnë brenda vitit buxhetor.

XIII. Mekanizmi dhe procedurat e monitorimit, lidhur me projektet e zbatuara, detajohen me akte të tjera nënligjore.

XIV. Procedurat që ndiqen në zbatim të pikave si më sipër, përcaktohen me akte nënligjore të Këshillit të Ministrave dhe/apo të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, si edhe të Ministrisë të Financave.

ANEKS 4 PËR KONVIKTET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Në transfertën e pakushtëzuar të disa njësive të qeverisjes vendore përfshihen edhe fondet për mbulimin e kostos së plotë të konvikteve të arsimit parauniversitar, ku përfshihen: fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator), shpenzimet operative, shpenzimet për mirëmbajtjen dhe investimet.

Njësitë e qeverisjes vendore, që në transfertën e pakushtëzuar kanë të përfshirë koston e konvikteve të arsimit parauniversitar, janë si më poshtë:

Bashkitë: Berat, Çorovodë, Peshkopi, Burrel, Durrës, Gjirokastër, Tepelenë, Përmet, Fier, Lushnjë, Elbasan, Cërrik, Gramsh, Korçë, Ersekë, Leskovik, Lezhë, Rrëshen, Rubik, Kukës, Krumë, Shkodër, Pukë, Tiranë, Vlorë dhe Sarandë.

Komunat: Qendër Fier, Golem Kavajë, Kelmend Malësi e Madhe dhe Bushat Shkodër.

Shpenzimet për personelin (paga dhe sigurime shoqërore) janë llogaritur mbështetur mbi numrin e punonjësve për secilin konvikt sipas aneksit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 16.04.2008, “Për administrimin e konvikteve të sistemit arsimor parauniversitar” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1710, date 29.12.2008, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 502, date 16.04.2008”, për punonjësit edukativë (zëvendësdrejtor dhe edukator).

Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore të personelit të këtyre konvikteve, njësitë e qeverisjes vendore do të mbështeten në kuadrin rregullator që ka përdorur Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Ministria e Arsimit dhe Sportit para fillimit të vitit fiskal 2014, duhet të dërgojë në njësitë e qeverisjes vendore gjithë kuadrin ligjor dhe nënligjor lidhur me pagat dhe sigurimet shoqërore për konviktet e arsimit parauniversitar.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Njësitë e qeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

ANEKS 5 PËR QENDRAT E SHËRBIMEVE SOCIALE

Në transfertën e pakushtëzuar të bashkive Berat, Elbasan, Shkodër, Kuçovë dhe Kukës janë të përfshira edhe fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit shërbyes dhe shpenzime operative për qendrat “Lira”, Berat, “Balash”, Elbasan, “Shpresa” Shkodër dhe qendrat ditore te

fëmijëve me aftësi të kufizuara për bashkinë Kuçovë dhe Kukës.

Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore të personelit të këtyre qendrave, bashkitë Berat, Elbasan, Shkodër, Kuçovë dhe Kukës do të mbështeten në kuadrin rregullator që përdor Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Njësitë e qeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

**ANEKSI 6
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**

Kriteret e formulës për shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar të financimit nga buxheti i shtetit për institucionet publike të arsimit të lartë-viti 2014			
Artikulli buxhetor, simboli dhe llogaritja	Koeficienti	Vlera (në mijë lekë)	Përshkrimi
1. Shuma totale për transferimet e pakushtëzuara për institucionet publike të arsimit të lartë			
Shuma totale për transfertat e pakushtëzuara [T]	100%	4,350,000	Sipas paragrafit 1 të nenit 76 të ligjit nr. 9741 “Për arsimin e lartë” (Ligji) transferta nga Buxheti i Shtetit për institucionet publike të arsimit të lartë (IAL) jepen si transferta të pakushtëzuara dhe si transferta me konkurrim për investime. Shuma në këtë rresht paraqet shumën totale të marrë nga buxheti për transfertat e pakushtëzuara. Paragrafi 1 i nenit 44 përcakton që shpërndarja e transfertës së pakushtëzuar bazohet në një formulë që garanton barazi, drejtësi dhe transparencë.
2. Ndarja bazë e sasisë totale për transfertën e pakushtëzuar për qëllime shpërndarjeje			
Shuma për paga dhe sigurime [P dhe S] = [T]*0,90	90%	3,915,000	Në fillim të procesit të përcaktimit të transfertave të pakushtëzuara për IAL-të e veçanta, MASH-i e ndan sasinë totale për transfertat e pakushtëzuara në 4 pjesë: shuma për paga dhe sigurime, shuma për mallrat dhe shërbimet për arsimin dhe funksionimin, shuma për kostot specifike të institucionit dhe shuma për funksionimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës për kërkimet.
Shuma për mallrat dhe shërbimet për arsimin dhe funksionimin [A dhe F] = [T]*0,5	5%	217,500	
Shuma për kostot specifike të institucionit dhe të zhvillimit [S dhe ZH] = [T]*0,02	2%	87,000	



Shuma për funksionimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës për kërkimet [IK] = [T]*0,03	3%	130,500	Secila prej këtyre pjesëve ndahet veçmas midis IAL-ve të veçanta duke përdorur procedura të ndryshme. Transferta e llogaritur për çdo IAL është shuma e sasisë së llogaritur për një IAL konkret, për secilën nga të katërt pjesët e përmendura më lart. Paraqitja e kësaj ndarjeje të brendshme është e nevojshme për të siguruar barazinë, drejtësinë dhe transparencën e të gjithë procesit të shpërndarjes. Përqindjet e përdorura për ndarjen në katër pjesë pasqyrojnë nevojat e IAL-ve dhe politikën e MASH-it.
3. Ndarja dhe metoda e shpërndarjes së sasisë për paga dhe sigurime			
Shuma për pagat dhe sigurimet e punonjësve ndihmës [P dhe S_PN] = [P dhe S_PN_2011]*1,05=(238394*1.05)=250,314 mijë leke		262,830	Për qëllime shpërndarjeje, sipas paragrafit 2 të nenit 46 të ligjit, personeli administrativ ndahet në punonjës profesionistë, punonjës ndihmës dhe punonjës administrativë. Punonjësit ndihmës përfshijnë punonjësit që kryejnë detyra të përgjithshme operacionale (p.sh. rojet, shoferët, zjarrfikësit, pastruesit dhe personeli i mirëmbajtjes). Meqë nevoja objektive e këtij stafi varet së tepërmi nga specifikat e IAL-së, metoda e indeksimit nga shpërndarja e vitit të mëparshëm përdoret për këtë kategori. (numri i punonjësve i parashikuar për vitin 2014)
Struktura bazë për paga dhe sigurime [P dhe S_SB] = 30 000 000. lekë * 13 IAL (UT, UMT,UPT,UBT, UA, US, USH, AA, UD, UE, UK, UGJ, UV)	sasia fikse 30 000 000 lekë për IAL	390,000	Për secilin IAL caktohet një shumë si një strukturë bazë për paga dhe sigurime. Kjo masë është e nevojshme për shkak të ekzistencës së IAL-ve të vogla në sistem.
Shuma për paga dhe sigurime për punonjësit e mësimdhënies shkencore, punonjësit administrativë dhe për punonjësit profesionistë e caktuar në përputhje me performancën e IAL-së në arsim. [P dhe S_PP] = ([P dhe S] - [P dhe S_PN] - [P dhe S_SB])*0,85	85%	2,772,845	Caktimi i pjesës më të madhe për paga dhe sigurime ndahet në 2 pjesë: 85% e shumës caktohet në përputhje me performancën e një IAL-ve të vetme në arsim dhe 15% në përputhje me performancën në kërkime. Shuma në këtë rresht caktohet në përputhje me performancën në arsim, që vlerësohet duke përdorur numrin e studentëve ekuivalentë me kohë të plotë (EKP) dhe numrin e të diplomuarve EKP

			në fusha studimi individuale duke marrë në konsideratë kërkesat për personel të arsimit në ato fusha studimi, të shprehura nga koeficienti i kërkesave personale (KKP). Gjithashtu merret në konsideratë edhe struktura e kualifikimit të stafit akademik. Ideja kryesore pas kërkesave për personel qëndron në faktin që fushat e veçanta të studimit ndryshojnë aq sa numri i studentëve që mund të mësohen nga një mësues (mesatarisht).
Shuma për paga dhe sigurime për punonjësit e mësimdhënies shkencore, punonjësit administrativë dhe punonjësit profesionistë e caktuar në përputhje me performancën e IAL-së në kërkime [P dhe S_PK] = (P dhe S] - [P dhe S_PN] - [P dhe S_SB])*0,15	15 %	489,326	Vlerësimi i performancës së kërkimeve në 2011 bazohet në 3 tregues (për vitet e ardhshme, përgatiten 6 tregues): niveli i përvetësimit të granteve për kërkime nga burime të brendshme, përmasat e studimeve të doktoraturës të shprehura nga numri i të diplomuarve dhe kapaciteti i kërkimeve i shprehur nëpërmjet numrit të profesorëve me kohë të plotë. Arsyeja objektive e përdorimit të pjesshëm të performancës së kërkimeve për caktimin e sasisë për paga dhe sigurime është fakti se aktiviteti i kërkimeve është pjesë themelore e punës së personelit akademik.
4. Ndarja dhe metoda e shpërndarjes së shumës për mallra dhe shërbime			
Shuma për mallra dhe shërbime për arsimin [M dhe SH_A] = [M dhe SH]*1/3	33.33 %	72,493	Shpenzimet për mallra dhe shërbime mund të ndahen në shpenzime që varen nga fusha e studimit dhe në shpenzime që nuk varen prej tyre (pra, ngrohje, ndriçim). Raporti i këtyre pjesë në formulë përcaktohet në 1:2. Pjesa e parë titullohet mallra dhe shërbime për arsimin. Sasia e kësaj pjesë është në këtë rresht dhe caktohet në përputhje me numrin e studentëve EKP të llogaritur nga koeficienti i kërkesave ekonomike (KKE). KKE-ja tregon kërkesat për kostot jopersonale të fushës përkatëse të studimit.
Struktura bazë për mallra dhe shërbime për funksionimin [M dhe SH_SB] = 10 000 000 Lekë * 11 _IAL	66.67 %	110,000	Pjesa e dytë e shpenzimeve për mallra dhe shërbime titullohet mallra dhe shërbime për funksionimin. Për secilin IAL,



Shuma për mallra dhe shërbime për funksionimin [M dhe SH_0] = [M dhe SH]*2/3 - [M dhe SH_SB]		35,007	sasia e kësaj pjese përbëhet nga një strukturë fikse bazë dhe një pjesë e caktuar në mënyrë proporcionale me numrin e studentëve EKP. Masa e strukturës bazë është e nevojshme për shkak të ekzistencës së IAL-ve të vogla në sistem.
5. Ndarja dhe metoda e shpërndarjes së shumës për kostot specifike të institucionit			
Shuma për kostot specifike të institucionit dhe të zhvillimit [S dhe ZH]	3%	87,000	Meqë mund të ekzistojnë raste të kostove specifike të IAL-ve që nuk janë të mbuluara nga pjesë të tjera të formulës, formula mundëson shpërndarjen e një shume për raste të tilla. Fondet për vende të veçanta pune ose mësimdhënie praktike në disa fusha janë një shembull i kostove specifike. Shpërndarja në këtë pjesë realizohet në bazë të kërkesave individuale të dorëzuara nga IAL që përmbajnë arsyetime dhe llogaritje kostosh për aktivitetet për të cilat kërkohet financimi. Shpërndarjet për kostot specifike të institucioneve limitohen vetëm ndaj artikujve jostandardë. Shuma e paraqitur në këtë radhë është një rezervë për kostot specifike të institucioneve në 2012. Një pjesë e shumës në këtë radhë gjithashtu mund të përdoret për shpenzime aktuale të projekteve zhvillimore të dorëzuara nga IAL-ja dhe të aprovuara nga MASH-i.
6. Ndarja dhe metoda e shpërndarjes së sasisë për funksionimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës kërkimore			
Shuma për funksionimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës kërkimore të shpërndarë sipas granteve të kërkimit nga burime të brendshme [IK_G.J]. = [IK]*1/3	33.33%	43,500	Përfshirja e shumës për funksionimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës kërkimore në formulë vjen nga angazhimi i fortë ndaj zbatimit të ligjit ku arsimit universitar duhet të bazohet në kërkime dhe njohuri shkencore dhe teknologjike bashkëkohore. Mbështetja për projektet e mirëfillta kërkimore ofrohet në mënyrë konkurruese nga burime të tjera të ndryshme. Por është e rëndësishme për IAL-në që
Shuma për funksionimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës kërkimore të shpërndarë sipas të diplomuarëve të studimeve të doktoraturës [IK_GB]. = [IK]*1/3	33.33%	43,500	

<p>Shuma për funksionimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës kërkimore të shpërndarë sipas kapacitetit kërkimor [IK_KK]. = [IK]*1/3</p>	<p>33.33 %</p>	<p>43,500</p>	<p>gjithashtu të kenë disa fonde për funksionimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së përbashkët kërkimore. Për arsye të një lidhjeje të ngushtë midis arsimit dhe kërkimit, një pjesë e këtyre fondeve duhet të ofrohet brenda transfertave të pakushtëzuara. Shpërndarja e shumës për funksionimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës kërkimore ndaj një IAL-je të vetme bazohet në performancën e kërkimit të vlerësuar duke përdorur kriteret dhe vlerat e paraqitura në këto rreshta. Shuma për këtë pjesë, e cila është 5% për vitin 2014, është planifikuar të rritet në vazhdim në vitet e ardhshme.</p>
<p>7. Minimumi i garantuar</p>			
<p>Minimumi i garantuar [MG] _Minimumi i garantuar shtesë deri në 3% me shumë ndaj realizimit të buxhetit për vitin 2013.</p>		<p>Minimumi i garantuar deri në 3%, ndaj buxhetit 2013</p>	<p>Në prezantimin e sistemeve të reja të financimit, është e nevojshme të sigurohet që ndryshimi në krahasim me sistemin e mëparshëm nuk do të jetë "shkatërrues" për asnjë subjekt. Për këtë arsye formula përmban një masë të quajtur minimumi i garantuar që siguron që transfera finale e pakushtëzuar për 2014 për secilin IAL do të jetë të paktën përqindja e specifikuar e shumës korresponduese që IAL ka marrë nga buxheti i shtetit në 2014. Kjo shumë quhet minimumi i garantuar për IAL-në. Mekanizmi funksionon në mënyrë të atillë që për IAL-të për të cilat transfera e pakushtëzuar e përcaktuar paraprakisht nga formula është me e ulët se sa minimumi i tyre i garantuar, transfera finale e pakushtëzuar për 2014 i përshtatet kësaj vlere në kurriz të IAL-ve me transfera paraprake më të larta sesa minimumi i tyre i garantuar. Impakti i këtij kompensimi ndaj IAL-së mbi minimumin e garantuar bëhet në mënyrë proporcionale ndaj rritjeve në lidhje me vlerat përkatës të minimumit të garantuar.</p>
<p>8. Vështrim mbi të ardhurat personale të IAL-ve</p>			



<p>Koeficienti i aftësisë për të siguruar të ardhura [KASA]</p>		<p>Sipas ligjit, IAL-të mund të mbajnë të gjitha të ardhurat dytësore nga shërbimet që sigurojnë.</p> <p>Formula përmban një mjet për ekuilibrimin e ndryshimeve objektive midis IAL-ve për sa i përket aftësisë së tyre për të siguruar të ardhurat të ardhurat dytësore nga shërbimet, të quajtur koeficienti i aftësisë së sigurimit të të ardhurave (KASA).</p> <p>Ky koeficient duhet të shprehë ndryshimet në të ardhurat të dhëna kryesisht nga rregullat e jashtme, përgjithësisht të ardhurat e siguruar nga tarifatat që lidhen me studimet, por jo ndryshimet që vijnë si rezultat i shkallëve të ndryshme të gatishmërisë dhe përpjekjeve të IAL-së për të ushtruar veprimtari që sigurojnë të ardhura.</p> <p>Vlera e plotë e këtij koeficienti, d.m.th., vlera 1 - KASA, është përdorur në llogaritjen e numrit të nxënësve me kohë të plotë.</p> <p>Vlera për IAL-të individualë për vit të dhënë, përcaktohet si raporti i të ardhurave të ardhurat dytësore nga shërbimet dhe buxhetit total të IAL-së në vitin ushtrimor. Kështu vlera 1-KASA për IAL është <i>de facto</i> vlera e kontributit të buxhetit shtetëror në buxhetin e IAL-së. KASA-t duhet të rillogariten çdo vit.</p>
--	--	---

Tab. 1
BUXHETI I VITIT 2014 SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS DHE INSTITUCIONEVE
BUXHETORE

në 000/lekë

Kodi	Emërtimi i institucionit / programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale				Totali i Shp. Kapitale	Totali i Shpenzimeve Buxhetore
			Nga Buxheti	Nga te Ardhurat	Financimi i Huaj			
1	Presidenca	178,200	5,000	0	0	5,000	183,200	
01120	Veprimtaria e Presidentit	178,200	5,000	0	0	5,000	183,200	
2	Kuvendi	993,500	48,500	0	0	48,500	1,042,000	
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	338,000	48,500	0	0	48,500	386,500	
01120	Veprimtaria Ligjvënëse	655,500	0	0	0	0	655,500	
3	Kryeministria	467,125	60,000	0	0	60,000	527,125	
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	467,125	60,000	0	0	60,000	527,125	
4	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	708,200	181,500	0	770,000	951,500	1,659,700	
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	217,200	41,000	0	50,000	91,000	308,200	
04130	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	276,000	108,500	0	650,000	758,500	1,034,500	
04160	Mbështetje për Mbikq. e Tregut, Infrast. e Ciles. dhe Pron. Industr.	215,000	32,000	0	70,000	102,000	317,000	
5	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave	4,614,610	925,110	0	2,359,734	3,284,844	7,899,454	
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	253,200	9,000	0	0	9,000	262,200	
04220	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	1,294,000	145,000	0	448,000	593,000	1,887,000	
04240	Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes	873,800	456,000	0	769,000	1,225,000	2,098,800	
04250	Zhvillimi Rural duke mbesht. Prodh. Bujq. Blek. Agroind dhe Market.	1,881,100	165,110	0	642,734	807,844	2,688,944	
04860	Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor	219,000	0	0	0	0	219,000	
05470	Menaxhimi qëndrueshëm i tokës bujqësore	21,000	0	0	0	0	21,000	
04230	Mbështetje për Peshkimin	72,510	150,000	0	500,000	650,000	722,510	
6	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	2,493,130	13,332,633	0	21,803,141	35,135,774	37,628,904	
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	266,500	10,000	0	79,000	89,000	355,500	
04520	Transporti rrugor	1,138,500	9,597,571	0	13,716,416	23,313,987	24,452,487	
04530	Mbështetje për Studime në Transport	19,730	1,000	0	0	1,000	20,730	
04540	Transporti detar	73,000	225,000	0	750,000	975,000	1,048,000	
04550	Transporti hekurudhor	461,900	105,000	0	0	105,000	566,900	
04560	Transporti ajror	23,000	5,000	0	0	5,000	28,000	
06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	510,500	3,239,062	0	6,917,725	10,156,787	10,667,287	
06220	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	0	150,000	0	340,000	490,000	490,000	
10	Ministria e Financave	5,414,340	466,500	0	745,000	1,211,500	6,625,840	
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	439,300	216,500	0	80,000	296,500	735,800	
01120	Menaxhimi i Shpenzimeve Publike	559,000	10,000	0	0	10,000	569,000	
01130	Ekzekutimi i Pagesave të Ndrivshme	869,000	0	0	0	0	869,000	
01140	Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore	2,045,480	83,000	0	0	83,000	2,128,480	
01150	Menaxhimi i të Ardhurave Doganore	1,439,260	155,000	0	665,000	820,000	2,259,260	
01160	Lufta kundër Transaksioneve Financiare Joligjore	62,300	2,000	0	0	2,000	64,300	
11	Ministria e Arsimit dhe Sportit	36,671,450	3,030,000	0	410,000	3,440,000	40,111,450	
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	738,000	49,500	0	0	49,500	787,500	
09120	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	23,150,000	1,800,000	0	0	1,800,000	24,950,000	
09230	Arsimi i Mesëm (i përgjithshëm)	5,226,450	771,738	0	0	771,738	5,998,188	
09240	Arsimi i Mesëm (profesional)	2,076,000	208,262	0	200,000	408,262	2,484,262	
09450	Arsimi Universitar	5,156,000	180,500	0	210,000	390,500	5,546,500	
09770	Fonde për Shkençën	177,000	0	0	0	0	177,000	
08140	Zhvillimi i Sportit	148,000	20,000	0	0	20,000	168,000	
12	Ministria e Kulturës	1,242,960	164,110	0	9,250	173,360	1,416,320	
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	133,900	5,000	0	0	5,000	138,900	
08220	Trashëgimia Kulturore dhe Muzejtë	380,420	53,930	0	9,250	63,180	443,600	
08230	Arti dhe Kultura	728,640	105,180	0	0	105,180	833,820	
13	Ministria e Shëndetësisë	28,329,500	790,000	0	1,200,000	1,990,000	30,319,500	
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	226,500	3,500	0	0	3,500	230,000	
07220	Shërbimet e Kujdesit Parësor	8,703,500	108,388	0	493,100	601,488	9,304,988	
07330	Shërbimet e Kujdesit Dytësor	16,880,500	648,112	0	706,900	1,355,012	18,235,512	
07450	Shërbimet e Shëndetit Publik	2,519,000	30,000	0	0	30,000	2,549,000	
14	Ministria e Drejtësisë	4,875,470	918,970	0	1,767,000	2,685,970	7,561,440	
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	333,700	887,070	0	1,017,000	1,904,070	2,237,770	
01120	Publikimet Zyrtare	49,750	100	0	0	100	49,850	
01130	Mjekësia Ligjore	50,500	12,000	0	0	12,000	62,500	
03440	Sistemi i Burgjeve	3,777,240	18,000	0	750,000	768,000	4,545,240	
03350	Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor	104,480	1,000	0	0	1,000	105,480	
01160	Shërbimet për çështjet e birësimeve	13,000	200	0	0	200	13,200	
01180	Shërbimi i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	430,600	500	0	0	500	431,100	



Fletorja Zyrtare
e Republikës së Shqipërisë

03490	Shërbimi i Provës	116,200	100	0	0	100	116,300
15	Ministria e Punëve të Jashtme	2,136,100	18,000	0	0	18,000	2,154,100
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	96,600	9,000	0	0	9,000	105,600
01120	Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	1,783,500	9,000	0	0	9,000	1,792,500
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ	256,000	0	0	0	0	256,000
16	Ministria e Brendshme	15,847,880	800,000	0	375,000	1,175,000	17,022,880
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	815,000	27,375	0	0	27,375	842,375
03140	Policia e Shtetit	11,716,380	673,499	0	337,000	9	12,726,879
03150	Garda e Republikës	1,182,800	30,000	0	0	30,000	1,212,800
01160	Prefekturat dhe Funksionet e Deleaguara te Pushtetit Vendor	555,200	10,000	0	0	10,000	565,200
01170	Shërbimi i Gjendies Civile	693,000	40,000	0	0	40,000	733,000
01180	Menaxhimi i Rezervave te Shtetit	96,700	6,000	0	0	6,000	102,700
10910	Emergjenca Civile	788,800	13,126	0	38,000	51,126	839,926
17	Ministria e Mbrojtjes	11,211,300	3,020,200	0	0	3,020,200	14,231,500
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,142,000	2,500	0	0	2,500	1,144,500
02120	Forcat e Luftimit	4,478,000	2,917,700	0	0	0	7,395,700
09430	Arsimi Ushtarak	826,000	0	0	0	0	826,000
02150	Mbështetje e Luftimit	4,195,700	50,000	0	0	50,000	4,245,700
